VENDIM
Nr.286, datë 28.4.2010

PËR HAPJEN E PROGRAMIT TË STUDIMEVE TË DOKTORATËS NË GJEOGRAFI, NË FAKULTETIN E HISTORISË DHE TË FILOLOGJISË TË UNIVERSITETIT TË TIRANËS, SI DHE PËR MIRATIMIN E KUOTËS SË PRANIMIT E TË TARIFËS SË SHKOLLIMIT NË KËTË PROGRAM STUDIMESH

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 26 pika 1.3.1, 34, 42 e 75 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Hapjen në Fakultetin e Historisë dhe të Filologjisë të Universitetit të Tiranës, të programit të studimeve të ciklit të tretë, të doktoratës, në gjeografi.

2. Në përfundim të këtij programi studimesh lëshohet diploma për gradën shkencore "Doktor (Dr.) në gjeografi".

3. Ky progam studimi e fillon veprimtarinë mësimore në vitin akademik 2009-2010.

4. Kohëzgjatja e këtij programi të studimeve të doktoratës është, të paktën, 3 (tre) vite akademike, ku përfshihen edhe 60 kredite për studime të organizuara.

5. Kuota e pranimit në këtë program studimi, për vitin akademik 2009-2010, është 30.

6. Nga kuota e përcaktuar në pikën 5 të këtij vendimi, për këtë program studimi, caktohet 10% për studentët nga trojet shqiptare jashtë kufijve të Republikës së Shqipërisë dhe administrohet nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, sipas kërkesave të institucioneve zyrtare të këtyre trojeve.

7. Kuotat e paplotësuara rishpërndahen nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

8. Tarifa e shkollimit për këtë program studimi të doktoratës është 200 000 (dyqind mijë) lekë dhe likuidohet për çdo vit të kohëzgjatjes normale, në këste të caktuara nga Fakulteti i Historisë dhe i Filologjisë i Universitetit të Tiranës.

9. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i Universitetit të Tiranës, pa efekte buxhetore shtesë.

10. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Universiteti i Tiranës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha